

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË ISTOG

PROJEKTET E MONITORUARA
“NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT ISTOG”
“NDËRTIMI I RRUGËVE NË MUZHEVINË, DREJË DHE LUBOVË”





Nëntor 2025

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË ISTOG

PROJEKTET E MONITORUARA
“NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT ISTOG”
“NDËRTIMI I RRUGËVE NË MUZHEVINË, DREJË DHE LUBOVË”



DEMOS Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje, përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjeshura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

HANDIKOS është themeluar në vitin 2000 me misionin për avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre të plotë në jetën shoqërore. Organizata mbledh një grup të gjerë personash me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre. Në aktivitetet e përditshme të organizatës, përveç asistencës për personat me aftësi të kufizuara, përfshihen edhe aktivitete në komunitet dhe avokimi për kategoritë e marginalizuara. Objektivi kryesor i HANDIKOS Istog është integrimi dhe njohja e plotë e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, përmirësimi i të drejtave të tyre dhe rritja e standardit jetësor të kësaj kategorie.



PËRMBAJTJA

7	Përmbledhja ekzekutive
8	GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT
8	Gjetjet në projektin specifik: Rregullimi i rrugëve në fshatrat Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë
8	Gjetjet në projektin e ndërtimit të shtratit të lumit në Istog
10	AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
11	KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË PROJEKTET E MBIKËQYRURA NË ISTOG
11	Gjetjet në organizimin e dëgjimeve buxhetore
12	Gjetjet në diskutimin e projekteve investive
13	Gjetjet në zbatimin e obligimit për të njoftuar qytetarët
13	Gjetjet në sigurinë e vendpunishtes
14	Gjetjet në qasjen e personave me aftësi të kufizuara
15	KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT”
15	Vonesat në procedurat e prokurimit dhe transparencën e projektit
15	Gjetjet të ndikimit në mjedis
16	Infrastrukturë për personat me nevojë të veçanta
16	Ndriçimi dhe siguria
16	Infrastrukturë shpesh dhe shërbime për qytetarët
17	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I RRUGËVE NË MUZHEVINË, DREJË DHE LUBOVË”
17	Gjetjet në sigurinë e rrugëve dhe kanaleve të ujitjes
17	Cilësia dhe mbikëqyrja e shtrimit të rrugëve
17	Statusi ligjor dhe qasja publike
18	PËRFUNDIME / REKOMANDIME
18	1. Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve
18	2. Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit
19	3. Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit
19	4. Rekomandimet për investime të reja në projekt
19	5. Rekomandimet për ndikimin në mjedis
20	6. Rekomandimet për qasjen e personave me aftësi të kufizuara
20	7. Rekomandimet për sigurinë e qytetarëve
21	METODOLOGJIA
22	Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?
22	Si u grumbulluan të dhënat?
23	Validimi i të dhënave
23	Përbërja e ekipit
23	Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social
24	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË ISTOG
25	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË ISTOGUT
26	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E ISTOGUT

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, BIRN dhe Handikos Istog lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Istogut. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua në mbikëqyrjen dhe analizimin e gjashtë projekteve investive me vlerë të përgjithshme prej 520,938 euro, duke përfshirë: “Ndërtimi i shtratit të Lumit Istog” dhe “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë”.

Ekipi i Auditimit Social punoi në grupe të veçanta për monitorimin në terren dhe pas përfundimit të projekteve zhvilloi konsultime të përbashkëta për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike për secilin projekt. Nga monitorimi u identifikuan një sërë çështjesh kryesore lidhur me transparencën, cilësinë e punimeve dhe respektimin e afateve kohore. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Istogut është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komonale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Istogu, i mbështetur nga projekti DEMOS, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga DEMOS dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023–2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë. Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200

rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale — HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŞA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimin financiar dhe komunikimin strategjik.

Në Istog, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 20 qytetarë u përzgjedhën për t'u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social. Trajnimet përfshinë ligjërime dhe praktikë në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, analizimin e dokumenteve dhe verifikimin e fakteve. Gjatë këtij procesi u kryen 10 vizita në terren dhe mbi 7 takime zyrtare. Ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Istogut u zotua për zbatimin e tyre.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komonale.

GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT



Komuna e Istogut nuk i ka zbatuar në plotni standardet e proklamuar nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në procesin e organizimit të dëgjimeve buxhetore.



Në vendpunishtet ku është implementuar projekti nuk ka pasur udhëzime të qarta për implementimin dhe detajet e projektit, siç kërkohet në udhëzimin e MAPL-së për transparencë.



Komuna nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar vendpunishten ku po zhvillohen punët.



Projektet investive nuk janë diskutuar në publik me qytetarët në fazën e tyre të planifikimit dhe komuna nuk ka të dhëna për konsultime të tilla.



Projekti i ndërtimit të shtratit të lumit është në vonesë në prokurim publik, duke rrezikuar planin dinamik të punimeve dhe fondet nga Granti i Performancës.



Komuna nuk i ka të planifikuara të gjitha fondet për të implementuar në tërësi projektin.

Gjetjet në projektin specifik:

Rregullimi i rrugëve në fshatrat Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë



Investimi i komunës nuk ka paraparë vendosjen e anësoreve që mbrojnë automjetet dhe qytetarët nga rreziku për aksidente.



Urat dhe kanalet e ujitjes skaj rrugëve të asfaltuara janë pa mbrojtëse dhe pa sinjalistikë të rrezikut.



Projekti nuk ka paraparë vendosjen e pengesave dhe sinjalistikës për uljen e shpejtësisë së automjeteve.



Banorët e zonës kanë evidentuar se në zonën e ndërtimit ka nevojë për ndriçim publik.

Gjetjet në projektin e ndërtimit të shtratit të lumit në Istog



Për shkak se projekti i ndërtimit të shtratit të lumit – faza e dytë – ende nuk është filluar (Nëntor 2025), ekipi i Auditimit Social ka analizuar projektin dhe punimet në fazën e parë, të cilat janë duke u zhvilluar. Rekomandimet janë nxjerrë me qëllim që faza e dytë e implementimit të përmbushë standardet.



Projekti nuk garanton qasje sipas standardeve për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e verbër.



Projekti nuk ka masa mbrojtëse të sigurisë për fëmijë në tërësinë e tij.



Projekti në fazën e parë ka paraparë betonizimin e shtratit të lumit, gjë që shkakton një ndikim të lartë në ambient.



Zona ku do të zhvillohet investimi ka drunj të vjetër, të cilët projekti i ri duhet të kujdeset t'i mirëmbajë.



Projekti i shëtitorës nuk ka paraparë një tualet publik, i cili është i nevojshëm në këtë zonë.



ÇKA DUHET TË DIJË NJË EKIP I AUDITIMIT SOCIAL?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë skajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar; si dhe, rekomandohet të kenë njohuritë bazike, në:

- Funksionimin e Komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun - sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në Komunë;
- Procesin e prokurimit publik.

AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Komuna e Istogut ka një popullsi prej 33,008 banorësh dhe është në mesin e komunave të mesme në Kosovë. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë REKOS2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)¹ tregojnë se numri i banorëve të Istogut është më i përafërt me Deçanin, Kaçanikun dhe Dragashin.

Buxheti i komunës arrin në 15,937,257 euro², nga i cili 4,237,000 euro janë ndarë për investime kapitale, duke përbërë rreth 26.6% të buxhetit të përgjithshëm.

Matja në Raportin e Performancës dhe vlerësimi i kriterëve të Grantit të Performancës e nxorën Istogun si komunë të kualifikueshme për të qenë përfituese e Grantit.

Granti i Performancës Komunale është një mbështetje financiare që u jepet komunave pas vlerësimit të performancës së tyre në menaxhimin e qeverisjes lokale. Granti në baza vjetore vlerëson mbi 100 indikatorë ku përfshihen transparenca, ofrimi i shërbimeve publike, planifikimi buxhetor dhe zbatimi i projekteve zhvillimore.

Istogu është në mesin e komunave përfituese të Grantit të Performancës Komunale. Si rezultat i menaxhimit të mirë dhe rezultateve të arritura, ajo është renditur në mes komunave përfituese të këtij granti, i financuar nga MAPL dhe DEMOS. Istogu në dy projektet ka përfituar rreth 1.1 milion euro.

Dy projektet e rëndësishme të përkrahura në këtë skemë janë, “Ndërtimi i shtratit të Lunit Istog” dhe “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë”.

Projekti për rregullimin e shtratit të lunit në Istog është një projekt jetik për komunitetin lokal të Istogut. Faza e parë e projektit është implementuar nga komuna ndërsa mjetet e Grantit të Performancës pritet të investohen në fazën e dytë të projektit.

Projekti tjetër i financuar nga mjetet e grantit “Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë”, po ashtu është me rëndësi për komunitetin pasi mbi 300 mijë euro janë shpenzuar në ndërtimin e këtyre rrugëve në këto tri fshatra, të cilat deri në këtë kohë ishin të paasfaltuara.



¹ REKOS 2024, Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë

² Buxheti i Komunës së Istogut

KAPITULLI I

GJETJET E PËRBASHKËTA NË PROJEKTET E MBIKËQYRURA NË ISTOG



Gjetjet në organizimin e dëgjimeve buxhetore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me mbështetjen e projektit DEMOS në vitin 2023 ripërcaktoi normativën ligjore mbi të cilën komunat e vendit zhvillonin procesin e konsultimit me qytetarët. Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në komuna përcaktoi standarde të avancuara në të cilat komunat organizojnë konsultimet me qytetarët dhe i publikojnë të dhënat publike.

Mbi këtë udhëzim komunat zhvillojnë takime me qytetarët me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të tyre në vendimmarrje. Sipas parimeve, Komuna konsulton qytetarët nëpërmjet:

- Takimeve publike;
- Konsultimit publik për projekte, aktet normative dhe dokumente të politikave;
- Takime konsultative me qytetarë;
- Dëgjime buxhetore.

Ekipi i Auditimit Social gjatë programit të trajnimeve u pajis me njohuri për obligimet e autoriteteve lokale për të zhvilluar procesin e konsultimeve publike dhe mbi këto parime kontrolloi nëse Komuna e Istogut kishte zbatuar standardet minimale të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur.

Ekipi analizoi dokumentet publike të komunës të cilat janë hartuar pas konsultimeve të zhvilluara nga komuna. Gjatë punës ekipi analizoi ftesat për dëgjimet publike, procesverbalet e takimeve dhe raportet përfundimtare nga dëgjimet buxhetore të publikuara në faqen e Komunës së Istogut.

Nga dokumentet e publikuara, procesverbalet dhe raportet, ekipi konstatoi se konsultimet publike gjatë vitit 2025 në Komunën e Istogut

kanë qenë një hap i rëndësishëm drejt forcimit të demokracisë lokale dhe transparencës institucionale.

Komuna ka mbajtur mbi 10 takime me qytetarët gjatë hartimit të dy dokumenteve të rëndësishme buxhetore, si korniza afatmesme buxhetore dhe buxheti i komunës. Nga raportet e publikuara në ueb-faqe ekipi ka konstatuar se pjesëmarrja e qytetarëve në këto dëgjime ka shkuar duke u rritur mirëpo ende takimet kanë më pak se 30 qytetarë në të.

Pjesëmarrja sipas gjinisë në konsultime publike është e dominuar nga rreth 65 % burra dhe 35 % gra, dhe në dëgjime jo të gjithë qytetarët paraqesin kërkesa.

Nga analizimi i procesverbaleve të dëgjimeve dhe raportit është konstatuar se raportet e hartuara nga grupi punues janë hartuar sipas rregullave mirëpo përmbajtja e tyre duhet të avancohet. Të dhënat nga procesverbalet dhe raportet finale tregojnë që përmbajtja është e mangët dhe kërkesat e qytetarëve janë evidentuar shumë shkurt ndërsa arsyetimet për pranimin ose mospranimin e kërkesave të qytetarëve janë të shkurta dhe formale.

Sipas Udhëzimit Administrativ për Transparencën Komunale, grupi punues i cili është i angazhuar në dëgjimet buxhetore duhet të ofrojë arsyetime të detajuara për pranimin apo refuzimin e projekteve të caktuara. Këtë arsyetime në Komunën e Istogut janë të shkurta dhe nuk ofrojnë një pasqyrë të qartë për arsyet e refuzimit.

Istogu është vlerësuar se ka përmbushur kriterin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike vetëm në masën 42%.

Një element tjetër i konstatuar gjatë analizimit të materialeve është mungesa e theksuar e zërit të personave me aftësi të kufizuar në dëgjimet specifike buxhetore në të cilat projektet e propozuara nuk kanë edhe komponentën e personave me aftësi të

kufizuar. Në tërësinë e dëgjimeve buxhetore nuk janë vërejtur situata ku është kërkuar adoptimi i tërësishëm i infrastrukturës për të garantuar qasje për personat me aftësi të kufizuar.

Në vrojtimin e materialeve online, grupi ka konstatuar se komuna i ka respektuar standardet e UA për të njoftuar qytetarët me orarin e takimeve dhe për të promovuar takimet në rrjetet sociale të komunës.



Gjetjet në diskutimin e projekteve investive

Neni 17 i [Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna](#) ka promovuar standardin që projektet investive të diskutohen me komunitetin në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Mbi këtë standard, hartuesit e projekteve dhe komunat do t'i diskutonin projektet para nisjes së implementimit të tyre me qëllim që projektet të jenë të plota dhe të familjarizuara për tërë komunitetin.

Mbi këtë standard, para nisjes së procesit të prokurimit dhe gjatë fazës së hartimit të projektit, komunat do të organizonin takime me qytetarët për të prezantuar projektin, mjetet në dispozicion dhe ndikimin e tij në komunitetin lokal.

Ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se për dy projektet e mbikëqyrura në Istog nuk janë zhvilluar takime të tilla formale me komunitetin.

Për shkak se projekti për shtratin e lumit është në fazën fillestare dhe ende nuk është shpallur tenderi, ekipi i Auditimit Social ka vendosur që të përfshihet në këtë format të diskutimit për të dhënë komentet e tyre në fazën përgatitore të projektit.

Bazuar në këtë parim, ekipi ka analizuar situatën në terren, ka diskutuar me zyrtarët e komunës dhe ka dhënë rekomandimet specifike të cilat do të duhej të implementoheshin në projekt.

Neni 17

Format përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje

1. Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

1.1 Takimeve publike;

1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;

1.3 Takime konsultative me qytetarë;

1.4 Dëgjime buxhetore.

2. Trajtimin e kërkesave peticioneve dhe kërkesave individuale e grupore të qytetarëve.

3. Me qëllim të marrjes së pikëpamjeve të qytetarëve në procesin vendimarrës, komuna siguron zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik të përcaktuara në këtë udhëzim Administrativ.

4. Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale.

5. Ueb faqja e komunës dhe platforma qeveritare për konsultime publike do përdoren si platforma për realizimin e qëllimeve të këtij neni.

6. Zyra për Komunikim me Publikun, është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën vendin, rendin e ditës, se kur do të mbahen takimet, degjimet buxhetore, konsultimet publike dhe takime tjera shtesë.



Gjetjet në zbatimin e obligimit për të njoftuar qytetarët

Udhëzimi Administrativ për Administratën e Hapur të Komunave kërkon nga autoritetet lokale që për të gjitha projektet investive komuna t'u ofrojë qytetarëve informacione të mjaftueshme për projektin. Mbi këto parime, komunat duhet të publikojnë kontratat dhe projektet investive në faqet e tyre zyrtare duke

u mundësuar qytetarëve qasje në to.

Ekipi ka gjetur se Komuna e Istogut ka publikuar kontratën për projektin e rrugëve, ndërsa projekti për shtratin e lumit nuk është e qasshme online.

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna

Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilën shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja. Me qëllim të rritjes së transparencës, komuna duhet të vendosë emrin, mbiemrin dhe kontaktet e menaxherit, mbikëqyrësit apo kompanisë mbikëqyrëse të projektit.

Në këtë situatë, ekipi ka analizuar edhe transparencën e projekteve në vendin ku ato ishin duke u zhvilluar. Sipas UA-së, komuna duhet të vendosë në secilin vendpunishte pano informuese në të cilat përmendet qartë investitori dhe emërohet personi i cili mbikëqyr kontratën.

Ekipi ka konstatuar se në projektin e rrugëve të dhënat e tilla mungojnë, pasi komuna nuk ka vendosur pano apo njoftime, ashtu siç e kërkon Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna.



Gjetjet në sigurinë e vendpunishtes

Ekipi i Auditimit Social gjatë vizitave në terren ka konstatuar se Komuna e Istogut nuk ka siguruar zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë të cilat kërkojnë sipas Ligjit për siguri dhe shëndet në punë në disa vendpunishte publike nën përgjegjësinë e saj.

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë obligon punëdhënësit dhe organet përgjegjëse të ndërmarrin masa për të siguruar vendin e punës dhe për të mbrojtur punëtorët nga rreziqet. Ligji përcakton përgjegjësinë e punëdhënësit për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut, krijimin e kushteve të sigurta të punës, trajnimin e punëtorëve dhe dhënien e udhëzimeve për përdorimin e pajisjeve dhe makinerive. Ai gjithashtu kërkon që punëdhënësi të caktojë persona të trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, të cilët monitorojnë dhe zbatojnë masat parandaluese, duke përfshirë dokumentimin e rreziqeve dhe masave të marra për parandalimin e tyre.

Detajet specifike për sinjalizimin dhe rrethimin e vendeve të rrezikshme nuk përfshihen drejtpërdrejt në ligj, por janë të përcaktuara në aktet nënligjore.

Në zonat ku janë zhvilluar punime në rrugë nuk janë vendosur shenja paralajmëruese apo sinjalizime për punimet në zhvillim, ndërsa projekti investiv për rregullimin e shtratit të lumit nuk është i rrethuar dhe zona e ndërtimit është e qasshme për qytetarët, duke përfshirë kalimtarët dhe fëmijët. Po ashtu, nuk janë vendosur udhëzime apo paralajmërime për rreziqet potenciale.

Konstatimi është edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh se Ligji për siguri dhe shëndet në punë i obligon kompanitë dhe organet përgjegjëse të ndërmarrin masa për të siguruar vendpunishtet, duke garantuar që ato të jenë të rrethuara, të sinjalizuara dhe të ofrojnë udhëzime për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet. Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor rrit ndjeshëm rrezikun për aksidente dhe dëmtime fizike.

Mungesa e masave të sigurisë në vendpunishtet publike paraqet rrezik serioz për sigurinë e qytetarëve dhe punëtorëve. Zonat e pambrojtura dhe pa sinjalizim mund të shkaktojnë aksidente, rënie ose lëndime fizike, përfshirë dëmtime të mjeteve, dhe krijojnë rrezik për përgjegjësi ligjore dhe financiare për komunën, si dhe dëmtojnë reputacionin e institucionit për moszbatim të standardeve bazë të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.



Gjetjet në qasjen e personave me aftësi të kufizuara

Gjatë procesit të Auditimit Social është konstatuar se projektet e shtrimit të rrugëve të komunës nuk kanë ndonjë qasje të avancuar për personat me aftësi të kufizuara. Për shkak se projektet kanë të bëjnë me rrugë, ato në tërësinë e tyre nuk kanë nevojë për përshtatje të larta për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, ekipi i Auditimit Social është fokusuar më tepër në analizimin e projektit të rregullimit të shtratit të lumit për të identifikuar problemet me qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

Duke analizuar projektin e shtratit të lumit, pjesa e parë e projektit, e cila është implementuar tashmë, ekipi ka konstatuar se në zonë nuk ka parking për personat me aftësi të kufizuara, nuk janë vendosur pllaka taktile për personat e verbër dhe nuk ka ulëse të përshtatura për personat që përdorin karrocë.

Në vërtetim është vërejtur se në fazën e dytë të projektit, që ka qenë në fokus të monitorimit,

Më 31.10.2025, ekipi i Auditimit Social i ka dërguar rekomandim Komunës së Istogut që të imponojë zbatimin e këtij rregulli. Gjatë procesit të Auditimit Social, Komuna e Istogut në përgjigjen e saj ka thënë se rrethimin dhe sigurimin e vendpushteve do të fillojnë ta zbatojnë menjëherë.³

disa nga urat e planifikuara nuk janë të përshtatshme për personat me karrocë.

Ekipi i Auditimit Social ka identifikuar se projektet e ardhshme duhet të përfshijnë masa konkrete për të siguruar qasje universale, përfshirë:

- parkingje të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara,
- shirita ndihmës për personat e verbër,
- ulëse të përshtatura për personat që përdorin karrocë,
- dhe infrastrukturë miqësore për përdoruesit e mjeteve ndihmëse të lëvizjes.

Këto mangësi tregojnë mungesë të përfshirjes së grupeve me nevoja të veçanta në projektim dhe implementim të infrastrukturës, duke rritur barrierat për qasje të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe duke mos respektuar parimet e dizajnit universal.



³ Komuna e Istogut_Takimi me drejtorin Genc Ademaj_06.11.2025

KAPITULLI II

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I SHTRATIT TË LUMIT”



Vonesat në procedurat e prokurimit dhe transparenca e projektit

Gjatë monitorimit të projektit për ndërtimit të shtratit të lumit në Istog në muajin shtator, ekipi ka konstatuar se ende nuk kanë filluar procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratës. Tenderi për ndërtimin e shtratit të lumit është hapur më 30.10.2025, dhe afati i fundit për pranimit të tenderëve/aplikacioneve është data 10.12.2025. Sipas njoftimit për kontratë, kohëzgjatja e kontratës do të jetë 24 muaj. Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 euro.

Ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se projekti duhet të jetë i publikuar dhe i qasshëm për qytetarët, për të garantuar transparencë dhe përfshirje të komunitetit në procesin e investimit. Publikimi i projektit i lejon qytetarët të jenë të informuar për ndërhyrjet, të japin komente dhe sygjerime, dhe ndihmon në rritjen e besimit të komunitetit ndaj investimeve publike. Kjo praktikë është gjithashtu e rëndësishme për të shmangur keqkuptimet, abuzime të mundshme me fondet dhe për të siguruar që zbatimi i projektit të jetë në përputhje me standardet ligjore dhe sociale.



Gjetjet te ndikimi në mjedis

Ekipi i Auditimit Social ka evidentuar se projektet aktuale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, sidomos në rastin e shtratit të lumit. Prerja e drunjve gjatë pastrimit të shtratit të lumit duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur prerjen e drunjve shumëvjeçarë dhe duke ruajtur biodiversitetin. Mbjellja e drunjve të rinj duhet të bëhet duke analizuar terrenin dhe duke zgjedhur specie të përshtatshme për klimën e Istogut, pasi përvoja nga komunat tjera tregon se drunjte e mbjellur pa planifikim nuk mbijetojnë vitin e parë.

Gjithashtu, komuna duhet të sigurojë që të mos lejohet shkarkimi i ujërave të zeza në pjesën e ndërtuar të lumit, derisa të vendosen impiantet për trajtimin e ujërave të zeza. Kjo masë është e nevojshme për të mos penguar shëtitjen e banorëve dhe për të parandaluar kundërmimin nga ujërat e zeza përgjatë lumit.

Ekipi i Auditimit Social rekomandon gjithashtu që të rivlerësohet projekti për shtrimin e fundit të lumit me gurë dhe beton, për shkak të dëmeve të mundshme mjedisore. Praktika nga Komuna e Malishevës ka treguar se betonizimi i pjesës së fundit të lumit ka shkaktuar tharjen e puseve pranë lumit dhe ka ndikuar negativisht te gjallesat që jetojnë në ujë.



Infrastrukturë për personat me nevoja të veçanta

Ekipi i Auditimit Social ka konstatuar se projekti i ndërtimit të shtratit të lumit në Istog nuk ofron qasje për personat me aftësi të kufizuara.

Projektet e ardhshme duhet të përfshijnë parkingje të rezervuara, shirit ndihmës për personat e verbër, ulëse për personat e verbër


dhe infrastrukturë për personat që përdorin karroca. Gjithashtu, projektet nuk kanë pllaka taktile për personat e verbër dhe nuk ofrojnë ulëse apo parkingje të përshtatura për personat me nevoja të veçanta.



Ndriçimi dhe siguria

Nga diskutimet me zyrtarët e komunës, por edhe nga tabela e projektit për shtratin e lumit, është konstatuar se deri më tani nuk është parashikuar ndriçim publik. Ekipi i Auditimit Social rekomandon që projekti të përfshijë ndriçim publik për të lehtësuar shëtitjen dhe

lëvizjen e qytetarëve gjatë orëve të mbrëmjes. Gjithashtu, mungesa e anësoreve mbrojtëse përgjatë shtratit të lumit paraqet rrezik për sigurinë e qytetarëve, duke marrë parasysh distancën e konsiderueshme nga shëtitorja deri te lumi.



Infrastrukturë shtesë dhe shërbime për qytetarët

Gjatë punës, grupi i Auditimit Social ka identifikuar nevojën për investime shtesë për të përshtatur hapësirat përreth lumit në Istog. Ekipi ka konstatuar se është e domosdoshme ndërtimi i një tualeti publik me pagesë në afërsi të shëtitoreve, i cili duhet të jetë i përshtatshëm edhe për personat me aftësi të kufizuara. Pagesa simbolike mund të shfrytëzohet për mirëmbajtjen e tij.

Gjithashtu, rekomandohet shtimi i urave për kalim nga njëra pjesë e lumit në tjetrën, të përshtatshme për të gjitha kategoritë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit me karroca. Aktualisht, tabela e projektit parashikon vetëm një urë harkore, e cila nuk duket e përshtatshme për kalimin e personave me aftësi të kufizuara.

KAPITULLI III

GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I RRUGËVE NË MUZHEVINË, DREJË DHE LUBOVË”



Gjetjet në sigurinë e rrugëve dhe kanaleve të ujitjes

Grupi i Auditimit Social ka konstatuar se në fshatin Muzhevinë kanali i ujitjes mbetet i hapur skaj rrugës, gjë që paraqet rrezik të madh për banorët, sidomos për fëmijët që lëvizin pranë tij.

Në gjatësinë e rrugës mungon sinjalizimi i qartë në zonat afër këtij kanali, i cili duhet të paralajmërojë banorët dhe vizitorët për praninë e kanalit të hapur, duke siguruar që lëvizja të jetë e sigurtë.

Ekipi i Auditimit Social rekomandon që ura mbi kanal të pajiset me anësore në të dy anët, për të parandaluar rëniet aksidentale. Ekipi po ashtu ka konstatuar se në zonë duhet të vendosen pengesa dhe shenja paralajmëruese në rrugë, për të rritur sigurinë e qytetarëve dhe fëmijëve që frekuentojnë këto hapësira. Gjithashtu, është e nevojshme të vendoset ndriçim publik dhe shporta për mbeturina përgjatë rrugëve të shtruara me asfalt, për të ruajtur sigurinë dhe higjienën e zonës.



Cilësia dhe mbikëqyrja e shtrimit të rrugëve

Ekipi i Auditimit Social në Istog ka konstatuar se shtrimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë duhet të mbikëqyret në mënyrë që trashësia dhe gjerësia e asfaltit të përputhen me projektin e miratuar. Shtrimi nuk duhet të pengojë kalimin natyral të ujit, për të shmangur rrezikun e përmbytjeve gjatë sezonave me shi.

Gjithashtu, grupi rekomandon që sinjalizimi i rrugëve të tregojë kufirin e peshës së automjeteve që lejohen të kalojnë, për të ruajtur integritetin e asfaltit. Komuna duhet

të sigurohet që shtrimi i rrugëve nuk do të dëmtohet nga shtrimi i rrjetit të kanalizimit apo ujësjellësit në të ardhmen dhe të vendosë kriter që rrugët të shtrohen vetëm në zonat ku infrastruktura nëntokësore është e planifikuar më parë, në mënyrë që të shmangen dëmtimet e asfaltit gjatë mirëmbajtjes ose riparimeve. Sinjalistika e rrugëve është e domosdoshme të realizohet, pasi pjesa më e madhe e rrugëve në zonën ku janë ndërtuar nuk kanë shenja të trafikut dhe vija të bardha.



Statusi ligjor dhe qasja publike

Ekipit të Auditimit Social konstaton se komuna duhet të sigurohet që të gjitha rrugët e shtruara të jenë publike dhe shtrimi i tyre të mos bie ndesh me ligjin. Kjo është e rëndësishme për garantimin e qasjes së lirë të qytetarëve dhe për respektimin e standardeve ligjore për pronësinë dhe përdorimin e infrastrukturës publike.



PËRFUNDIME / REKOMANDIME


Ekipi i Auditimit Social në fund të projektit ka analizuar punën dhe ka arritur në disa përfundime të cilat i janë dorëzuar komunës në formë të rekomandimeve.

Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:



1. Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve

- Gjatë hartimit të projekteve, Komuna duhet të promovojë diskutimin e tyre në fazën e planifikimit, ashtu siç rekomandon Udhëzimi Administrativ për Transparencën Komunale.
- Gjatë zhvillimit të dëgjimeve buxhetore dhe hartimit të dokumenteve, Komuna duhet të ofrojë arsyetime të detajuara për pranimin ose refuzimin e projekteve investive.
- Në të ardhmen, Komuna e Istogut duhet të publikojë projektet në detaje, dokumentet e menaxhimit të kontratës, faturat e paguara, punët e kryera dhe të paguara, ndryshimet e kontratës dhe arsyetimin e këtyre ndryshimeve.
- Komuna duhet të implementojë obligimin për vendosjen e tabelave informuese për projektet, duke bërë publik emrin e mbikëqyrësve të projekteve dhe kontaktet e tyre.
- Duhet të gjenden metoda alternative për të përfshirë më shumë gratë dhe personat me aftësi të kufizuar në dëgjimet dhe konsultimet buxhetore.




2. Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit

Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, grupi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Procedurat e prokurimit të jenë në kohë, për të shmangur humbjen e fondeve nga donatorët dhe për të respektuar afatet e kontratave.
- Në projektet e planifikuara, të sigurohet qasja e personave me aftësi të kufizuar sipas standardeve.
- Projektet të planifikohen për të garantuar qëndrueshmëri afatgjate dhe të shmanget nevoja për intervenime të reja në anësore, mbrojtëse të urave dhe kanaleve të ujitjes.


3. Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social, ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Mbikëqyrja e punimeve të jetë aktive dhe të sigurojë që puna të realizohet sipas projektit dhe standardeve.
- Sinjalistika rrugore duhet të ketë vëmendje të veçantë gjatë mbikëqyrjes.
- Vendorsja e shenjave paralajmëruese dhe barrierave mbrojtëse në të gjitha vendpunishtet publike dhe rrugët ku zhvillohen punime.
- Sigurimi i rrethimit të zonave të ndërtimit, veçanërisht për shtratin e lumit, për të parandaluar hyrjen e qytetarëve, veçanërisht fëmijëve.
- Vendorsja e udhëzimeve të qarta për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet potenciale në vendpunishtet.

4. Rekomandimet për investime të reja në projekt



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Të ndërtohet shteg për orientimin e personave të verbër pranë shëtitores së lumit.
- Të vendosen ulëse të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.
- Në disa zona të shëtitores së lumit të vendosen parkingje të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.
- Të vendosen sinjalistika shtesë në rrugët e ndërtuara në fshatrat e Istogut.

5. Rekomandimet për ndikimin në mjedis



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Prerja e drunjve të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke ruajtur drunjtë shumëvjeçarë dhe biodiversitetin.
- Mbjellja e drunjve të rinj të planifikohet duke marrë parasysh përshtatshmërinë për klimën dhe terrenin e Istogut.
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të zeza në shtratin e lumit deri sa të vendosen impiantet për trajtimin e tyre.
- Të rishikohet plani i betonizimit të shtratit të lumit për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe burimet ujore pranë lumit.

6. Rekomandimet për qasjen e personave me aftësi të kufizuar



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Të sigurohet qasje universale në projektet e shtrimit të lumit dhe rrugëve, duke përfshirë:
 - Parkingje të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.
 - Pllaka taktile për personat e verbër.
 - Shirita ndihmës dhe ulëse të përshtatura për personat e verbër.
 - Infrastrukturë familjare për personat që përdorin karroca.
- Të shtohen ura të përshtatshme për të gjitha kategoritë dhe personat me nevoja të veçanta.

7. Rekomandimet për sigurinë e qytetarëve



Gjatë zhvillimit të procesit të Auditimit Social ekipi ka arritur të hartojë rekomandimet si në vijim:

- Vendosja e ndriçimit publik në shëtitore, rrugë dhe zona të punimeve për të lehtësuar lëvizjen gjatë natës.
- Vendosja e anësoreve mbrojtëse në shtratin e lumit dhe afër rrugëve me trafik të lartë për të parandaluar aksidentet.
- Vendosja e sinjalizimit për kufirin e peshës së automjeteve dhe shenjat paralajmëruese të rrezikut përgjatë rrugëve.
- Sinjalistika e rrugëve dhe pengesat për uljen e shpejtësisë së automjeteve për të rritur sigurinë e qytetarëve.
- Sigurimi që rrugët e shtruara të jenë publike dhe të mos bien ndesh me ligjin.

METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në gjashtë komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim
Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim
Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit) 301,155 € (rrugët)	Tenderim Implementim

Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dyshemeve-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim

Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?

Grupi i Auditimit Social është një grup i qytetarëve të cilët në mënyrë vullnetare i përgjigjen nismës për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve. Me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të komunitetit, BIRN dhe D+ në bashkëpunim me OJQ-të lokale partnere të projektit, hartuan një listë me profesione dhe përfaqësues të komunitetit, të cilët janë ftuar për t'u bashkëngjitur në grup.

Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktua se grupi synonte t'u jepte prioritet përfshirjes së kategorive të marginalizuara të shoqërisë siç janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat

me aftësi të kufizuara dhe komunitetet jo-shumicë. Synohej që grupi të kishte laramani të profesioneve dhe moshave me qëllim të garantimit të gjithëpërfshirjes.

Ekipet e OJQ-ve partnere të projektit nën fasilitimin e BIRN dhe D+ kontaktuan mbi 200 qytetarë nga 6 komunat për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e grupeve. Mbi 120 qytetarë nga komunat e synuara u bënë pjesë e grupeve.

Në Istog u themelua grupi me 22 qytetarë, të cilët kanë punuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizozi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për

të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Istogut. Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 22 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar nga Handikosi në Istog, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të BIRN. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Istogut.


Validimi i të dhënave

Ekipi i Auditimit Social në Istog ka punuar në identifikimin e problemeve në projektet e që janë implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet sistematike në dy projektet dhe për gjetjet specifike të projekteve individuale. Ekipi u dakordua edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë

raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, Genc Ademaj, i cili është edhe mbikëqyrës i kontratave, dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

Përbërja e ekipit

Përbërja e ekipit: **22 anëtarë**



Jurist; Ekonomist; Gazetar; Fizioterapeut; Pensionist; Polic; Kontabilist; Inxhinier/ Profesor; Profesor i Edukimit Fizik; Banor të zonave ku zhvillohen projektet; Afarist; Përfaqësues/ Shoqata e të Verbërve, Istog; Përfaqësues/ Shoqata Handikos Istog; Përfaqësues të shoqërisë civile

Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social

Gusht 2025	<ul style="list-style-type: none"> Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Istogut Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale
Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none"> Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga Handikos në Istog Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Istogut Trajnimi i ekipit të Auditimit Social Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Istogut Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim Takimi i ekipit me Menaxherin e Kontratës
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none"> Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit Ndarja e detyrës për shkrimin e raportit për kryesuesin e ekipit të Auditimit Social, nga Handikos Istog. Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social.

EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË ISTOG

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Vjosa Zogaj	Fizioterapeute
2	Fabian Ferizaj	Gazetar
3	Ajmane Metaj	OJQ Forca e Gruas
4	Aferdita Kerellaj	Banore e fshatit Drejë
5	Shemsi Kerellaj	Banor i fshatit Drejë
6	Nezir Jahaj	Jurist
7	Besarta Gorqaj	Shoqata e të Verbërve - Istog
8	Esat Shabanaj	Shoqata e të Verbërve - Istog
9	Suzana Haxhijaj	Trajnere / Syri Vizion
10	Azdren Hasanaj	OJQ LIRIA I
11	Emirjana Demaj	Juriste / Police
12	Fatime Mustafaj	Pensioniste
13	Mirdita Kurtaj	Banore e fshatit Muzhevinë
14	Diolinda Kurtaj	Banore e fshatit Muzhevinë
15	Sinavere Dreshaj	Banore e fshatit Lubovë
16	Elfete Mehaj	OJQ Vizion 02
17	Njomza Alijaj	Anëtare e Handikos - Istog
18	Vesel Kajtazaj	Banor i fshatit Lubovë
19	Blendineta Shatri	Kontabiliste
20	Shkelqim Januzaj	Profesor
21	Fidan Qeta	Inxhinier
22	Shengyle Delijaj	Anëtare e Handikos - Istog

LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË ISTOGUT



*Të dashur qytetarë të Komunës së Istogut,
të nderuar bashkëpunëtorë të projektit “Auditimi Social”,*

Për mua dhe për Komunën e Istogut është kënaqësi e veçantë të jemi pjesë e këtij projekti me rëndësi, të realizuar nga BIRN dhe DEMOS. Ky bashkëpunim është dëshmi e angazhimit tonë të vazhdueshëm për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të hapur ndaj qytetarëve tanë. “Auditimi Social” është një qasje moderne që ndihmon komunat të matin efektin real të projekteve në jetën e përditshme të qytetarëve.

Përmes këtij procesi, ne jo vetëm që analizojmë anën teknike dhe financiare të investimeve, por gjithashtu marrim mendimet dhe vlerësimet e vetë qytetarëve, atyre që përfitojnë drejtpërdrejt nga këto projekte. Në Istog, përmes këtij projekti janë shqyrtuar disa investime infrastrukturore të rëndësishme, të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në qytet dhe fshatra.

Gjetjet e këtij auditimi na ndihmojnë të kuptojmë më mirë se ku jemi, çfarë kemi bërë mirë dhe ku duhet të punojmë më shumë për të qenë më efikasë e më të përgjegjshëm ndaj jush, qytetarëve tanë. Një ndër vlerat më të mëdha të “Auditimit Social” është përfshirja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Ky projekt ka krijuar hapësira të reja për dialog e bashkëpunim ndërmjet komunës dhe shoqërisë civile, duke ndërtuar një kulturë të re komunikimi e bashkëveprimi.

Pikërisht ky bashkëpunim është themeli i një qeverisjeje transparente dhe të drejtë. Në përmbyllje, dua të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim të sinqertë për BIRN dhe DEMOS për mbështetjen profesionale, bashkëpunimin e ngushtë dhe përkushtimin e tyre në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm. Faleminderit gjithashtu të gjithë qytetarëve tanë që kanë marrë pjesë me ide, komente e sugjerime gjatë procesit. Komuna e Istogut do të vazhdojë të jetë e hapur për çdo iniciativë që rrit llogaridhënien dhe e bën qeverisjen më afër njerëzve. Komunë e drejtë dhe transparente për të gjithë.

*Me respekt,
Ilir Ferati - Kryetar i Komunës së Istogut*

LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E ISTOGUT



Kur pranova ftesën për t'u bërë pjesë e ekipit komunitar në auditimin social për projektin e ndertimit të shtratit të lumit në Istog dhe rregullimin e rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë”, e mora si një përgjegjësi të rëndësishme. Ishte një mundësi për të përfaqësuar zërin e qytetarëve dhe për të ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Ky ekip është i përbërë nga qytetarë të komuniteteve të ndryshme, moshave të ndryshme dhe përfaqësues të organizatave lokale. Diversiteti i tij e ka pasuruar procesin e auditimit, sepse kemi sjellë perspektiva të ndryshme, nevoja të ndryshme dhe përvoja reale nga terreni.

Projektet që po auditojmë janë të financuara nga MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) dhe projekti Zviceran “DEMOS”. Si pjesë e granteve për performancë të mirë komunale. Ndaj edhe përgjegjësia për zbatimin e drejtë dhe efektiv të tyre është edhe më e madhe. Deri tani, përmes vëzhgimeve në teren dhe takimeve me banorët, kemi evidentuar disa gjetje si vonesa në punime, mungesë informimi të banorëve dhe nevoja për kontroll më të mirë të cilësisë.

Që nga fillimi, jemi angazhuar në monitorimin e zbatimit të këtyre projekteve përmes vëzhgimeve në terren, takimeve me qytetarë dhe diskutimeve me autoritetet komunale. Deri tani, kemi identifikuar disa gjetje të rëndësishme që janë pjesë e këtij raporti. Ky proces më ka bërë të kuptoj më thellë rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare dhe fuqinë që kemi si komunitet për të kërkuar llogari dhe për të ndikuar në vendimmarrje.





Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige